

Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Raport Mujor Shtator 2019

Informacion bazë

Menaxhimi i Fondit

**Raiffeisen
INVEST**

Monedha

LEK

Vlera fillestare e kuotës

1,000

Shuma fillestare minimale

1,000

Shuma minimale pasuese

1,000

Komision në hyrje

0%

Komision në dalje

0%

Penalite ne rast terheqje te parakohshme

**Sipas rregullores
se AMF-se**

Komision Administrimi ne vit

1.50%

Kosto per transferte fondesh nga pale te treta

**Referojuni
informacionit ne
deget e RBAL**

Objektivi i investimit dhe profili i investitorit

Fondi i Pensionit Vullnetar është një mënyrë alternative kursimi, e përdorur ekskluzivisht për kursime afatgjata për vitet pas largimit përfundimtar nga puna. Ky fond zotërohet bashkërisht nga anëtarët e fondit dhe menaxhohet nga Shoqëria Administruese Raiffeisen Invest sh.a, në bazë të kontratës së lidhur me anëtarët e fondit.


Asetet e Fondit do të investohen sipas parimit të sigurisë afatgjatë dhe të një kthimi të përshtatshëm nga investimi, duke ruajtur një raport optimal mes rritjes së kursimeve për pension dhe rrezikut të marrë përsipër.

Fondi synon të ndërtojë një portofol të përbërë kryesisht nga tituj borxhi te emetuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me maturim afatgjatë (me maturim më të lartë se një vit).

Profili i Rrezikut dhe Përfitimit

Rrezik i ulët
Përfitimet tipike më të ulëta

Rrezik i lartë
Përfitimet tipike më të larta



Fondi është në kategorinë e parë të Profilit të Rrezikut dhe Përfitimit, pra në kategorinë me rrezik më të ulët.


Treguesi i rrezikut dhe përfitimit korrespondon me një numër të plotë i cili përdoret për të renditur fondin në një nivel rreziku nga 1 në 7, sipas nivelit të rritjes së luhatshmërisë. Kategoria më e ulët nuk do të thotë që investimi në fond është pa rrezik. Ky tregues ka për qëllim tju informoje mbi luhatshmërinë e çmimit të kuotës së fondit bazuar në historikun e performancës së fondit. Të dhënat historike të përdorura për llogaritjen e treguesit nuk mund të përbëjnë një siguri të plotë për profilin e rrezikut në të ardhmen.

Të dhëna për Fondin në 30.09.2019

Vlera Neto e Aseteve	717,472,333
Numri i investitoreve	3,027
Cmimi i Kuotes	1,787.4104
*Kthimi vjetor nga investimi (30.09.2018-30.09.2019)	5.11%

*Komisioni i administrimit zbritet përpara llogaritjes së kthimit nga investimi

Struktura e portofolit të investimeve në 30 Shtator 2019



Ne kuader te politikës se investimit te fondit te Pensionit, investimet do te kryhen kryesisht ne bono thesari dhe obligacione, te emetuara ne tregun primar, duke patur parasysh qe aktiviteti i tregimit te titujve te borxhit te emtuar nga Qeveria shqiptare ne treg sekondar eshte i kufizuar.

Instrumenti

Ne % te Aseteve te Fondit

Obligacione Thesari	98.04%
Depozita / Llogari rrjedhese	1.96%

Bonot e thesarit 12 mujore emetohen dy here ne muaj; Obligacionet 2 vjeçare nje here ne muaj; 7 dhe 10 vjeçare jane me te rralla, afersisht nje here ne tre muaj. Qeveria organizon ankande te obligacioneve referencë 5 dhe 3-vjeçare me frekuence nje here ne 2 muaj per secilin maturitet. Strategjia e investimeve vazhdon te jete e fokusuar ne investime afatgjate.

Vlera neto e asetëve të fondit është rreth LEK 717 milione në datë 30 Shtator 2019.


Ecuria e normave te interesit te letrave me vlere te Qeverise Shqiptare gjate muajit Shtator

Gjate muajit Shtator, u stabilizua ecuria e normave te interesit te titujve te emetuar nga Qeveria Shqiptare. Norma e Bonos se Thesarit 12 mujore dhe obligacionit reference 5 vjeçar paten nje rritje te lehte ne krahesim me ankandin parardhes, nderkohe qe normat e tjera te ankandeve te obligacioneve pesuan renie. Ky ndryshim ne trendin e normave eshte ndikuar kryesisht nga rritja e nivelit te likuiditetit ne treg, gje qe rezultoi edhe me pjesemarrje te larte ne ankandet e titujve. Gjate muajit Shtator obligacioni 2 vjeçar i emetuar ne LEK pesoi ulje ne yield me 15 pike baze duke arritur ne nivelin 2.59%; Gjithashtu obligacioni 7 vjeçar pesoi ulje me 5 pike baze duke arritur ne nivelin 4.19%.

Yield-i mesatar i ponderuar ne ankandin primar per Bono Thesari 12 mujore rezultoi ne 2.262%, duke u rritur me 8 pike baze ne krahesim me normen e vendosur ne ankandin e fund muajit Gusht qe ishte 2.183%.

Gjate muajit Shtator u zhvillua edhe ankandi i obligacionit reference 5 vjeçar, norma e interesit e te cilit u rrit me 11 pike baze ne krahasim me ankandin e fundit qe ishte organizuar ne Korrik 2019, duke arritur ne nivelin 3.537%.

Grafiku me poshte jep nje pasqyre te ecurise se normave te interesit te bono dhe obligacioneve thesari te emetuar nga Qeveria Shqiptare gjate periudhes 1-vjeçare Shtator 2018 – Shtator 2019. Per obligacione reference 3 dhe 5 vjeçare jane paraqitur yields fiks te perlogaritura nga kuotimet e kontributoreve ne fund te muajit Shtator te cilat kane pasur nje trend renes gjate ketij muaji.




Performanca e fondit dhe ecuria e çmimit të kuotës deri në 30 Shtator 2019

Çmimi i kuotes se Fondit te Pensionit ka ndjekur nje trend rrites gjate muajit dhe vlere e kuotes eshte rritur me 0.39% gjate muajit Shtator dhe 3.65% gjate vitit 2019. Kthimi vjetor neto i fondit eshte 5.11% per periudhen Shtator 2018 – Shtator 2019; Ai eshte me i ulet karahasuar me vitet e meparsheme sepse edhe normat e interesit te titujve te Qeverise, ne te cilat fondi investon, kane gene ne renie gjate viteve te fundit. Kthimi i fondit ndryshon ne varesi te kushteve te tregut, sic jane ndryshimet ne normat e interesit te titujve te Qeverise.


Kthimi mesatar vjetor neto qe nga momenti i lancimit te fondit ne 2010 deri ne 30 Shtator 2019 eshte 6.86%.

Ne daten 30 Shtator 2019 performanca e fondit eshte 6.13% (norme vjetore) per nje periudhe 5 vjecare.

Ne daten 30 Shtator 2019 performanca e fondit eshte 5.25% (norme vjetore) per nje periudhe 2 vjecare.



Kthimi vjetor neto historik per Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen



Anetaret e fondit te Pensionit keshillohen te kene nje horizont sa me te gjate qendrimi ne fond (mundesisht deri ne moshen e pensionit, pese vjet para moshes se percaktuar ne Ligj) per te perfitur nje kthim maksimal nga investimi, per te permiresuar standartin e jeteses ne moshen e pensionit dhe per te evituar penalitetet ne rast terheqje te parakohshme.

Të dhënat e kthimit nga investimi në të shkuarën janë vetëm ilustrative dhe nuk përfaqësojnë një premtim apo garanci për kthimin në të ardhmen. Te gjithë shembujt e tjere numerike, jane perdorur per qellime ilustrative dhe analize te te dhenave historike, dhe nuk duhen perdorur nga investitoret per te nxjerre konkluzione per te ardhmen.

Investitorët e mundshëm janë të ftuar të lexojnë Prospektin dhe Rregullat e Fondit. Raiffeisen Invest dhe bankieret e Raiffeisen Bank nuk garantojnë një kthim të caktuar të fondit. Informacioni mbi çmimin e përditësuar të kuotës, prospektin dhe rregullat e Fondit gjendet pranë zyrave të Raiffeisen INVEST sha, në web site www.raiffeisen-invest.al, ose në degët e Raiffeisen Bank në Shqipëri.